



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

ANALIZË E PROJEKTLIGJIT PËR DIASPORËN

Prishtinë, 2018

© 2018 Germin

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Germin ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr."Tringë Smajli". Nr.48
10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: germinks@gmail.com

Web: www.diasporaflet.org

Autor: GERMIN

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

HYRJE

Për vite me rradhë, Diaspora vazhdon të jetë kontribues kyç në ekonominë e Republikës së Kosovës, dhe në zhvillimin e saj shoqëror e politik. Sipas burimeve të ndryshme, dëshmohet që afër gjysma e popullatës së Kosovës jeton jashtë territorit të shtetit amë, duke e bërë kështu diasporën me origjinë nga Kosova një numër të konsiderueshëm në Evropë dhe Amerikë.

Shteti i ri i Kosovës konsiderohet si një nga shtet me Diasporën më të madhe në proporcion me numrin e përgjithshëm e qytetarëve mbrenda vendit. Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, mbi 35% të të gjithë popullsisë kishte emigruar në Gjermani dhe më pas në Zvicër me rreth 23% si dhe në Itali mbi 7%.¹

Mjetet financiare, përfshirë këtu edhe remitencat e mërgimtarëve, vazhdojnë të kenë ndikim shumëdimensional në shoqërinë tonë. Përveç përmirësimit të drejtpërdrejtë të mirëqenies në Kosovë, migrimi gjithashtu ka ndikim në zhvillimin njerëzor jo vetëm përmes dërgimit të remitancave, por edhe përmes shpenzimeve të diasporës kur ata vizitojnë Kosovën, investimeve, transferit të dijës etj. Në vitin 2017, remitancat ishin baraz me 15% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), dhe sipas Bankës Qendrore të Kosovës paraqesin kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, me vlerë prej 759.2 milionë euro.²

Megjithatë, remitancat paraqesin vetëm një pjesë e potencialit të Diasporës për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës. Mirëpo, shteti i Kosovës duhet të fillojë të analizojë dhe ofrojë ura tjera lidhëse pasi që ekziston një nevojë që institucionet e Kosovës të përfshijnë në mënyrë aktive pjesëtarët e Diasporës në çështjet sociale e politike.

Në lidhje me këtë, Qeveria e Kosovës në vitin 2011 themeloi Ministrinë e Diasporës duke bërë disa përparime të nevojshme me qëllim të organizimit të diasporës në njohjen dhe rëndësinë e kontributit të tyre. Me hapjen e kësaj Ministrie, filluan të krijohen dhe zhvillohen programe të cilat synojnë të ofrojnë hapësirë për angazhimin e Diasporës në zhvillimin dhe demokratizimin e vendit. Kësisoj, në vitin 2012 Kuvendi i Republikës së

¹ *Migrimi në Kosovë*. Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014, <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

² *Raporti Vjetor 2017*. Banka Qendrore e Kosovës, Qershor 2017, https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf

Kosovës miraton bazën ligjore me të cilën obligon Kosovën që të ruajë dhe kultivojë identitetin kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës përmes Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën 04/L-095³.

Ky ligj ka definuar Qendrat Kulturore të Diasporës, Mësimin Plotësues në Diasporë dhe krijimin e lidhjeve ekonomike në mes të Diasporës dhe shtetit të tyre amë. Por, me ndryshimin e kompetencave të Ministrisë së Diasporës dhe avancimit të kornizës ligjore për Diasporën, këtë vit Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike(MDIS) ka inicuar Projektligjin për Diasporën, draft i cili parashikon obligimet dhe zotimet e Qeverisë së Kosovës ndaj këtij komuniteti. Është e rëndësishme të potencohet se MDIS edhe në vitin 2017, në koordinim me institucionet e linjës dhe bashkëpunim me shoqërinë civile kishin filluar përpilimin e Projektligjit për Diasporën⁴. Pas konsultimeve me publikun dhe ndryshimeve në ekzekutiv, projektligji ishte kthyer në pikën zero.

Prandaj, ky punim synon të vë në dukje sfidat e Qeverisë së Kosovës rreth draft-ligjit aktual dhe jepë rekomandime konkrete për përmirësimin e Projektligjit të propozuar për Diasporën.

PROJEKTLIGJI PËR DIASPORËN DHE ELEMENTET KRYESORE

Projektligji për Diasporën, i cili është inicuar nga MDIS dhe është hartuar nga grupi punues parashikon obligimet që ka Kosova ndaj pjesëtarve të diasporës. Sipas përshkrimit të neni 1:

Ky projektligj ka për qëllim krijimin dhe rregullimin e raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, përcaktimin e statusit të pjesëtarëve të diasporës, mbrojtjen ose përkujdesjen për të drejtat sociale, politike, kulturore, ekonomike dhe të interesave të tjera të diasporës.

Edhe pse thotë që do të mbrojë interesat politike të pjesëtarëve të diasporës, draft-ligji aktual nuk propozon mekanizma lehtësues për votimin jashtë vendit dhe mekanizma për përfaqësimin e Diasporës në Kosovë.

³ Ligji nr.04/L- 095 për Diasporën dhe Mërgatën. Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës, 3 Korrik 2012, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2831>

⁴ Kusari, Kaltrina. "Projektligji Për Diasporën: Integrues Apo Përrjashtues.", 26 Tetor, 2017, <http://diasporaflet.org/projektligji-per-diasporen-integrues-apo-perjashtues/>

Ndër elementet kryesore që ky projektligj përmban janë:

- Formati i Qendrave Kulturore në Diasporë;
- Atashe për Diasporën;
- Statusi i Pjesëtarit të Diasporës;
- Investimet Strategjike & Transferi i dijës; dhe
- Themelimi i Kanalit për Diasporën.

Për Projektligjin e propozuar, i cili ka disa mangësi, Germin pas takimeve në Diasporë dhe diskutimeve virtuale, jepë në vazhdim një listë të propozimeve të cilat urojmë të adresohen në fazën e fundit të finalizimit të projektligjit.

Në tabelën e mëposhtme janë vetëm disa nga paragrafet kryesore që rekomandojmë të ndryshohen.

Projektligji për Diasporën	Propozim nga Germin
<p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky ligj ka për qëllim krijimin dhe rregullimin e raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, përcaktimin e statusit të pjesëtarëve të diasporës, mbrojtjen ose përkujdesjen për të drejtat sociale, politike, kulturore ekonomike dhe të interesave të tjera të diasporës.</p>	<p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Germin rekomandon që të largohet pjesa “dhe të interesave të tjera të diasporës” dhe “krijimin”</p> <p>Rekomandon të riformulohet si në vazhdim:</p> <p>Ky ligj ka për qëllim rregullimin e raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, përcaktimin e statusit të pjesëtarëve të diasporës, mbrojtjen dhe përkujdesjen për të drejtat sociale, politike, kulturore dhe ekonomike.</p> <p>Ne, poashtu, propozojmë që në projektligjin aktual të vendosen dy nene për avancimin e të drejtave politike të Diasporës:</p> <ol style="list-style-type: none">1.Promovimi dhe avancimi i pjesëmarrjes së Diasporës në zgjedhjet në Kosovë;2.Përfaqësimi i Diasporës në vendimmarje dhe politikëbërje. <p>Duke cenuar këto të drejta, nuk mund</p>

	të flasim për një kornizë ligjore e cila ka mision ri-strukturimin e nevojave dhe promovimin e të drejtave të Diasporës.
Neni 2 Fushëveprimi	<p>Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Germin rekomandon që fushëveprimi të riformulohet vetëm në bazë të fushave prioritare dhe të shtohet paragrafi i mëposhtëm:</p> <p>1.9. Të krijohet partneritet midis Kosovës dhe vendeve ku jeton Diaspora e saj në mënyrë që të ndërlihen dhe kombinohen me efikasitet politikat e migracionit dhe zhvillimit, duke përfshirë edhe rrjetet e diasporës (profesionistët, shoqatat dhe organizatat egzistuese aktive në diasporë dhe për diasporën), në mënyrë që të krijohet një situatë e favorshme për të gjithë akterët, për të mundësuar mes tjerash edhe qarkullimin e trurit.</p>
Neni 3 Përkufizimet	<p>Neni 3 Përkufizimet</p> <p>Germin rekomandon që të riformulohen definicionet dhe listimi të jetë në bazë të hirarkisë dhe prioriteteve.</p>
Neni 4 Marrëdhëniet me pjestarët e Diasporës	<p>Neni 4 Marrëdhëniet me pjestarët e Diasporës</p> <p>Germin rekomandon që të shtohet paragrafi 4</p> <p>Ministria siguron dhe garanton pjesëmarrjen e pjesëtarëve të diasporës në përpilimin e politikave dhe projekteve që kanë të bëjnë me diasporën.</p>
	<p>1. Zhvillimi i marrëdhënieve të diasporës me Republikën e Kosovës bëhet në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>2. Ministria ndërton marrëdhënie me pjesëtarët e diasporës për të ruajtur kohezionin kulturor, social,</p>

<p>politik, arsimor, shkencor, ekonomik, etj.</p> <p>3. Marrëdhëniet me pjesëtarët e diasporës janë pjesë integrale e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.</p>	
<p>Neni 5 Bashkëpunimi ndërkombëtarë</p> <p>1.Republika e Kosovës lidh dhe zbaton marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare që mbrojnë interesat, të drejtat dhe pozitën e pjesëtarëve të diasporës.</p> <p>2.Republika e Kosovës proklamon integrimin dhe pjesëmarrjen e pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore dhe politike të vendeve;</p>	<p>Neni 5 Bashkëpunimi ndërkombëtarë</p> <p>Ne propozojmë që të riformulohet paragrafi 2 si në vazhdim:</p> <p>Republika e Kosovës proklamon integrimin dhe pjesëmarrjen e pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore dhe politike të vendeve ku ata jetojnë.</p> <p>Dhe të shtohen edhe një paragraf tjetër në këtë nen si në vijim:</p> <p>Përfshinë ekspertët nga diaspora në procesin e negociimit të marrëveshjeve ndërshtetërore që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë të bëjnë me diasporën.</p>
<p>Neni 6 Institucionet përgjegjëse</p> <p>1. Ministria është institucioni kryesor përgjegjës për krijimin dhe përparimin e marrëdhënieve të Republikës së Kosovës me pjesëtarët e diasporës.</p> <p>2. Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes mekanizmit të saj institucional, është përgjegjëse t'i mbrojë interesat e pjesëtarëve të diasporës, duke ruajtur dhe kultivuar identitetin kombëtar, kulturor dhe arsimor të pjesëtarëve të diasporës.</p>	<p>Neni 6 Institucionet përgjegjëse</p> <p>Germin konsideron që paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë:</p> <p>Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes mekanizmit të saj institucional, është përgjegjëse t'i mbrojë interesat e pjesëtarëve të diasporës, duke ruajtur dhe kultivuar identitetin kombëtar, kulturor dhe arsimor të pjesëtarëve të diasporës, përshkak se kështu e cenon strukturën dhe rrjedhën e hierarkisë.</p> <p>Poashtu, Germin propozon që paragrafi</p>

<p>3. Ministritë e linjës në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Komunitet e Kosovës dhe institucionet e tjera që në kuadër të fushëveprimit të tyre kanë aktivitete që lidhen me diasporën, janë përgjegjëse për krijimin e mardhanjeve me diasporën.</p> <p>4. Qendra Kulturore në Diasporë është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve në diasporë brenda fushëveprimit të saj të përcaktuar me këtë ligj.</p>	<p>4 të largohet dhe të zëvendësohet në këtë formë:</p> <p>Ministria promovon dhe mbështetë krijimin e Këshillit të shoqatave dhe organizatave të diasporës në vendet e ndryshme; si dhe krijimin e një Këshilli të përgjithshëm Kombëtar të Diasporës, përmes delegimit dhe përfaqësimit demokratik.</p> <p>Në vazhdimësi, rekomandojmë t'i shtohet paragrafi 5 këtij neni:</p> <p>Krijimi i Këshillit të përgjithshëm të diasporës që përfaqësohet në organet dhe strukturat institucionale në të gjitha nivelevet të Kosovës që kanë të bëjnë me raportet diasporë-vend amë.</p>
<p>Neni 7 Përgjegjësit e Ministrisë</p>	<p>Neni 7 Përgjegjësitë e Ministrisë</p> <p>Germin rekomandon që të ri-formulohen përgjegjësitë, të cilat me draft ligjin aktual e ngarkojnë Ministrinë, përkundër buxhetit minimal, kapaciteteve dhe stafit të kufizuar.</p> <p>Germin rekomandon që të inkuadrohen vetëm paragrafi i mëposhtme:</p> <p>1.1.Harton, zbaton dhe koordinon studime, hulumtime, programe të fushës së diasporës dhe investimeve strategjike si dhe të kapitalit human të diasporës stë saj.</p> <p>1.2.Është urë lidhëse dhe komunikuese për pjesëtarët e diasporës me institucionet e Republikës së Kosovës, duke nxitur, promovuar dhe duke koordinuar investimet në vend</p>

	<p>dhe bartjen e përvojave e kapitalit njerëzor të diasporës.</p> <p>1.3.Harton dhe zbaton politika në sferat shoqërore për pjesëtarët e Diasporës.</p> <p>1.4.Koordinon dhe përkrah investimet nga diaspora në Kosovë dhe bartjen e kapitalit human (arsimor, social, kulturor, politik, bashkë me dijen, përvojat e aftësitë profesionale të krijuara e të pasuruara në diasporë).</p> <p>1.5.Mbështet financiarisht Qendrat Kulturore të Kosovës</p> <p>1.6.Ndihmon krijimin e lidhjeve/rrjeteve të bashkëpunimit të diasporës në fushat ekonomike, sociale, politike, shkencore, arsimore, kulturore, sportive, bashkëpunimit juridik, shëndetësisë, teknologjive të reja dhe fushat e tjera ndërmjet pjestarëve të diasporës dhe Republikës së Kosovës.</p> <p>1.7.Me miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet e shteteve të tjera për përmirësimin e pozitës së pjesëtarëve të diasporës konform të drejtave universale të njeriut si dhe përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën shoqërore e politike të Kosovës dhe shteteve ku ata jetojnë.</p> <p>1.8.Në koordinim me Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë dhe institucioneve tjera, promovon mundësitë e investimeve</p>
--	--

	<p>strategjike në Kosovë dhe qarkullimin e trurit përmes migrimit qarkor;</p>
<p>Neni 8 Dita e Diasporës Ministria jep çmimet vjetore për personat, shoqatat dhe institucionet për kontribut të veçantë në diasporë.</p>	<p>Neni 8 Dita e Diasporës Germin rekomandon që të riformulohet paragrafi 2 si në vijim:</p> <p>Ministria në konsultim me përfaqësuesit e rrjeteve të diasporës në vendet e caktuara përzgjedh dhe jep çmimet vjetore për personat, shoqatat dhe institucionet për kontribut të veçantë në diasporë.</p>
<p>Neni 9 Procedurat e themelimit të Qendrave Kulturore në Diasporë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qendrat Kulturore në Diasporë themelohen me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe forcimit të lidhjeve të tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. 2. QKD-të themelohen në vendet me interes për diasporën dhe për Republikën e Kosovës. 3. QKD-të veprojnë në kuadër të misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në vendin e pritjes. 4. Përmes marrëveshjeve bilaterale me shtete që kanë interesa të përbashkëta, Republika e Kosovës mund të themelojë edhe qendra të përbashkëta kulturore. 	<p>Neni 9 Procedurat e themelimit të Qendrave Kulturore në Diasporë:</p> <p>Germin propozon që të largohet paragrafi 3:</p> <p>QKD-të veprojnë në kuadër të misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në vendin e pritjes.</p> <p>Hapja e qendrave të reja duhet të koncentrohet fillimisht në vendet ku kemi numër më të madh të pjesëtarëve të Diasporës dhe mungesë të misioneve diplomatike. Tutje, qendrat nuk duhet të limitojnë shtrirjen e tyre vetëm në misionet diplomatike; Ato mund të hapen nga organizatat kulturore të themeluara në Diasporë.</p> <p>Për këtë, Germin sugjeron që Qendrat Kulturore të themelohen si <i>fondacione</i>, me përkrahje të limituara financiare nga Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë. Përmes marrëveshjeve të përbashkëta në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe</p>

	shtetit pritës, qendrat mund të hapin degët e tyre nëpër qytete të ndryshme ku kemi pjestarë të Diasporës.
<p>Neni 10, Përgjegjësitë e QKD-ve</p> <p>1. QKD-të kanë përgjegjësitë si në vijim</p> <p>1.1. Promovojnë njohuri të përgjithshme për Kosovën.</p> <p>1.2. Nxitin dhe promovojnë gjuhët, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës.</p> <p>1.3. Nxitin bashkëpunimin në fushat me interes për pjesëtarët e diasporës dhe Republikës së Kosovës, si dhe me shtetin pritës.</p> <p>1.4. Koordinojnë dhe promovojnë mundësitë e investimeve në Kosovë.</p> <p>1.5. Organizojnë dhe ndihmojnë organizatat e ndryshme joqeveritare të diasporës për realizimin e aktiviteteve kulturore, arsimore, sportive, rinore dhe aktiviteteve të tjera me interes për pjesëtarët e diasporës.</p> <p>1.6. Organizojnë dhe mbajnë takime me pjesëtarët e diasporës dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës.</p> <p>1.7. Mbështetin dhe organizojnë të rinjtë dhe grup-moshat e ndryshme të pjesëtarëve të diasporës.</p> <p>01.8 Realizojnë hulumtime dhe analiza të ndryshme për diasporën.</p> <p>1.9. Kryejnë edhe detyra të tjera, të përcaktuara nga Qeveria dhe legjislacioni tjetër në fuqi.</p>	<p>Neni 10, Përgjegjësitë e QKD-ve</p> <p>Germin propozon që ky nen të largohet dhe si i tillë të kalohet në aktin nën-ligjor për hapjen e qendrave kulturore.</p> <p>Po ashtu, Germin rekomandon që Qendrat Kulturore, si të propozuara nuk duhet të institucionalizohen 100%, por të hapen duke marr shembull modelet e tjera si: British Council, Gotte Institute, L'Alliance Française etj. <i>Sipas modelit të British Council, qendrat e kulturës duhet të kenë një bord menaxhues, i cili mund të përbëhet nga: Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë; Përfaqësuesit nga shoqëria civile dhe Përfaqësues nga Diaspora - dhe duke u financuar pjesërisht nga organet qeveritare.</i></p>

<p>Neni 12 Drejtori i Qendrës</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori i QKK-së do ta ketë gradën diplomatike të atasheut të Republikës së Kosovës për diasporën. 2. Drejtori i QKK-së vepron në kuadër të misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në shtetin pritës. 3. Mënyra e funksionimit të QKK-së brenda misionit diplomatik do të rregullohet me akt nënligjor, i propozuar nga Ministria përkatëse e Diasporës dhe me miratim të Qeverisë, në përputhje me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm. 4. Drejtori i QKK-së, për punën e tij, e informon rregullisht ambasadorin e Republikës së Kosovës dhe i raporton ministrit përkatës të Diasporës. 5. Procedura dhe kriteret e përzgjedhjes së drejtorit të QKK-së rregullohen me akt nënligjor, i propozuar nga Ministria përkatëse e Diasporës, me miratim të Qeverisë. 	<p>Neni 12 Drejtori i Qendrës</p> <p>Germin propozon që ky nen të largohet. Zgjedhja e drejtorit të qendrës mund të rregullohet me akt nën-ligjor. Poashtu, zgjedhja e drejtorit/koordinatorit të Qendrës nuk duhet të bëhet nga MDIS, por nga bordi menaxhues, propozim i dhënë më lartë.</p>
<p>Neni 13 Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës zyrtare</p>	<p>Neni 13 Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës zyrtare</p> <p>Germin rekomandon të shtohet ky paragraf 5.6 si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">Promovon barazvlefshmërinë e gjuhëve, nxit dhe inkurajon pjestarët profesionistë të arsimit në diasporë të jenë pjesë e përpjekjeve për instutucionalizim të barazvlefshmërisë së gjuhëve</p>

<p>Neni 17 Statusi i pjesëtarit të diasporës</p> <p>1. Statusi i pjesëtarit të diasporës mund të fitohet nga qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, nga ata qytetarë me prejardhje nga Kosova, por pa shtetësi; bashkëshortët e tyre pa origjinë nga Kosova, fëmijët e tyre (të lindur dhe të birësuar), të cilët kanë kontribuar për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe avancimin e unitetit kulturor.</p> <p>2. Këtë status mund ta marrin edhe miqtë e Republikës së Kosovës dhe popullit të saj, të cilët kanë kontribuar për Pavarësinë e Kosovës dhe avancimin e diasporën në vendet pritëse.</p> <p>3. Njohja e statusit të pjesëtarit të diasporës, pa shtetësi, nuk nënkupton përkatësinë kombëtare dhe nuk paragjykon procedurën për marrjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës.</p>	<p>Neni 17 Statusi i pjesëtarit të diasporës</p> <p>Germin konsideron që ky nen përbën një hap shumë të mirë, mirëpo rekomandon që paragrafi 2 të largohet. I formuluar kështu si është në formën e tanishme lë hapësirë për keqpërdorime dhe abuzime.</p>
<p>Neni 19 Nxitja dhe promovimi i investimeve të diasporës dhe investimeve strategjike</p> <p>1. Qeveria, me qëllim të nxitjes së investimeve nga diaspora, angazhohet që bizneset e diasporës të jenë sa më afër me institucionet e Kosovës, në mënyrë që të mundësohet përfaqësimi i interesave të tyre në politikën ekonomike shtetërore.</p> <p>2. Ministria, me qëllim të nxitjes së investimeve të diasporës dhe</p>	<p>Neni 19 Nxitja dhe promovimi i investimeve të diasporës dhe investimeve strategjike</p> <p>Germin rekomandon që nenit 19, t'i shtohet kjo pjesë:</p> <p>Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme Koordinohet rreth aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të Diplomacisë Ekonomike.</p> <p>Po ashtu rekomandon që të</p>

<p>investimeve strategjike, inkurajon dhe krijon ura bashkëpunimi ndërmjet rrjeteve dhe asociacioneve të bizneseve dhe biznesmenëve të diasporës me Republikën e Kosovës dhe bizneseve në Kosovë.</p> <p>3. Ministria, në bashkëpunim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, harton dhe promovon programe të veçanta për biznese të diasporës.</p> <p>4. Ministria, në bashkëpunim me institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, harton dhe zbaton programe në fushën e investimeve strategjike.</p>	<p>riformulohet titulli si në vijim:</p> <p>Nxitja dhe promovimi i bartjes së kapitalit human dhe investimeve të diasporës</p>
<p>Neni 21 Hulumtimet dhe mbledhja e të dhënave për bizneset e diasporës</p> <p>Neni 22 Mbledhja e të dhënave për biznese</p> <p>Neni 28 Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës</p>	<p>Neni 21 Hulumtimet dhe mbledhja e të dhënave për bizneset e diasporës</p> <p>Neni 22 Mbledhja e të dhënave për biznese</p> <p>Neni 28 Mbledhja e të dhënave për pjesëtarët e diasporës</p> <p>Në projektligjin e propozuar, aktualisht janë 3 nene të cilat synojnë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Germin rekomandon që këto të bashkohen në një nen të vetëm: Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për bizneset, pjesëtarët e diasporës dhe grupet formale, jo-formale.</p> <p>Germin, propozon që nenit 21 Hulumtimet dhe mbledhja e të dhënave për bizneset e diasporës tek paragrafi 3. Ministria realizon hulumtime dhe analiza në fushën e investimeve të diasporës dhe në fusha të tjera me interes për diasporën t'i shtohet Përmes krijimit të</p>

	Departamentit të veçantë për Analiza Ekonomike të Bizneseve të Diasporës, Ministria e Diasporës harton analiza të hollësishme të potencialit të bizneseve në diasporë dhe zhvillon projekte ekonomike.
--	--

PËRFUNDIME

Projektligji për Diasporën, i cili parashikon shumë ndryshime dhe elemente të reja të cilat paraqesin obligimet e reja të Qeverisë ndaj pjesëtarëve të Diasporës, ka shumë paqartësi dhe mangësi.

GERMIN, duke qenë se një kohë të gjatë ka avokuar për shumicën e ndryshimeve që ky projektligj sjellë, jemi të vetëdijshëm që pa avancimin e të drejtave politike, gjë që e cila mungon në këtë projektligj nuk mund të krijojmë një marrëdhënie të frytshme të bazuar në reciprocitet. Si edhe në herat e kaluara, GERMIN sërish i bënë thirrje Qeverisë që të avancojë dhe promovojë të drejtën e votës, të drejtën për t'u përfaqësuar si dhe të krijojë politika të cilat do të forcojnë besimin e ndërsjelltë.

Krijimi i qendrave të kulturës në Diasporë është më se e nevojshme, dhe si grup e kemi përsëritur tash e dy vite. Mirëpo, në lidhje me këtë rekomandojmë që Qeveria, respektivisht Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike duhet të japë informata të detajuara për mbylljen e tri qendrave aktuale duke botuar raportin vlerësues për këtë veprim. Për këtë, ne kundërshtojmë formën aktuale të propozuar për krijimin e qendrave të reja, duke mbështetur idenë që qendrat e kulturës të hapen me ligj të veçantë dhe të merret për bazë modeli i British Council apo edhe fondacioneve të tjera.

Në këtë kuptim dhe duke njohur rolin e jashtëzakonshëm që Diaspora ka bërë për zhvillimin e Kosovës, drafti i propozuar nuk duket i kompletuar, duke lënë shumë hapësirë për keqinterpretime. Për këtë, propozimet e dhëna shpresojmë që do të merren parasysh në mënyrë që ligji të përfaqësojë dhe të mbrojë të drejtat kulturore, politike, ekonomike dhe shoqërore të bashkatdhetarëve.

Germin do të vazhdoj të mbështesë Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investimeve Strategjike në nismat për monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe në çfarëdo programi që avacon dhe mbron të drejtat e qytetarëve jashtë vendit.

BIBLIOGRAFIA:

Diskutim me Komunitetin në Mynih. Germin, 2018, Raporti i fokus grupit. 13 tetor, 2018

Diskutim me Komunitetin në Cyrih. Germin, 2018, Raporti i fokus grupit. 17 tetor, 2018

Diskutim me Komunitetin në Graz. Germin, 2018, Raporti i fokus grupit. 20 tetor, 2018

Kusari, Kaltrina. "Projektligji Për Diasporën: Integrues Apo Përjashtues." *Albinfo*, 26 Oct. 2017,
www.albinfo.ch/projektligji-per-diasporen-integrues-apo-perjashtues/.

Ligji nr.04/L- 095 për Diasporën dhe Mërgatën. Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës, 3 Korrik 2012, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2831>

Migrimi në Kosovë. Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014, <http://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

Raporti Vjetor 2017. Banka Qendrore e Kosovës, 2018, *Raporti Vjetor 2017*,
www.bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf.